



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME / SPECIJALNA KOMORA VRHOVNOG SUDA / SPECIAL CHAMBER OF THE SUPREME COURT

Palati i Drejtësisë, Objekti A, Rruga Nekibe Kelmendi, 10510 Hajvali / Palata Pravde, Objekat A, Ulica Nekibe Kelmendi, 10510 Hajvali / Palace of Justice, Building A, Nekibe Kelmendi Street, 10510 Hajvali

VËRTETIMI MBI DORËZIMIN E DOKUMENTIT

Duke u bazuar në Ligjin nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, pala e nënshkruar më poshtë vërteton pranimin e dokumentit:

Ndërmarrja: Preduzeće: Enterprise:

1. Trepça Confection

- Socially Owned Enterprise • Production of Protective Workers Clothing • Mitrovicë

Paditës
Tužilac
Claimant

I paditur
Tuženi
Respondent

1. Agjencia Kosovare e Privatizimit

- Authority • Privatization • Rr. "Dritan Hoxha" nr.55, Lakrishte, Prishtinë

POTVRDA O DOSTAVI DOKUMENTA

Na osnovu Zakona br. 04/L-033 o Specijalnoj komori Vrhovnog suda Kosova za pitanja koja se odnose na Kosovsku agenciju za privatizaciju, dole potpisana stranka potvrđuje dostavu dokumenta navedenog dole:

Numëri i lëndës: Broj predmeta: Case Number:

C-IV.-24-0108

ACKNOWLEDGEMENT OF RECEIPT OF A DOCUMENT

Pursuant to Law no 04/L-033 on Special Chamber of the Supreme Court of Kosovo on Privatization Agency of Kosovo Related Matters, the below signed party acknowledges receipt of the document described below:

Data e regjistrimit: Datum registrovanja: Date registered:

23/08/2024

Përfaqësues
Punomočnik
Representative

Përfaqësues
Punomočnik
Representative

#	Titulli i Dokumentit:	Naziv dokumenta:	Document Name:	Datë Datum Dated
1	Aktvendim nga Dhoma	Rešenje komore	Decision of the Chamber	02/08/2024

Pala: Stranka: Party: 1. Agjencia Kosovare e Privatizimit
Authority • Privatization • Rr. "Dritan Hoxha" nr.55, Lakrishte, Prishtinë

Pranuar nga: Primio: Received by: _____
Titulli: Zvanje: Title: _____
Data: Datum: Date: _____
Nënshkrimi Potpis: Signature: _____





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO



Numri i lëndës: 2024:201110

Datë: 21.08.2024

Numri i dokumentit: 06073214

C-IV-24-0108

02 gusht 2024

Parashtruesi i kërkesës

Autoriteti i Likuidimit (AL), i Ndërmarrjes Shoqërore MIT034 Ndërmarrja Shoqërore “Trepça Konfeksioni” në likuidim – Mitrovicë e Jugut

Agjencia Kosovare e Privatizimit, rr. “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.

Për: Parashtruesin e kërkesës

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtarja Hajrie Shala, me 02 gusht 2024, lëshon këtë:

AKTVENDIM

- 1. Aprovohet** Raporti Përfundimtar i AL-së të Ndërmarrjes Shoqërore MIT034 Ndërmarrja Shoqërore “Trepça Konfeksioni” në likuidim – Mitrovicë e Jugut.
- 2. Lejohet** mbyllja e rastit të likuidimit ndaj kësaj Ndërmarrje.
- 3. Lirohet** AL nga çdo detyrë e mëtutjeshme në lidhje me procedurat e likuidimit, përveç për ekzekutimin e ndonjë shpërndarjeje përfundimtare që nuk është realizuar ende.



Rrethanat faktike dhe procedurale

Me dt.16 korrik 2024, parashtuesi i kërkesës ka dorëzuar në Dhomën e Posaçme raportin përfundimtar të likuidimit të Ndërmarrjes Shoqërore (tani e tutje NSH) të MIT034 Ndërmarrja Shoqërore "Trepça Konfeksioni" në likuidim – Mitrovicë e Jugut. Tutje ka propozuar që pas shqyrtimit shkresave të dorëzuara të aprovoj Raportin Përfundimtar dhe të bie vendim mbi lejimin e mbylljes së rastit të likuidimit ndaj kësaj ndërmarrje. Parashtuesi i kërkesës më tej ka pohuar se këtë kërkesë e paraqet në pajtim me nenet 43 dhe 44 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (më tutje: Shtojca e Ligjit të AKP-së).

Arsyetimi ligjor

Dhoma e Posaçme, pas shqyrtimit të kërkesës, konstaton se kërkesa është e bazuar dhe si e tillë duhet të aprovohet.

Sipas nenit 43 paragrafi 1, të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, Autoriteti i Likuidimit, pas përfundimit të plotë apo përfundimit substancial të realizimit të pronës së Ndërmarrjes sipas likuidimit, apo pas mbylljes së rastit të Likuidimit, ia parashtron raportin përfundimtar Dhomës së Posaçme.

Paragrafi 2 i këtij neni përcakton se Raporti përfundimtar përmban:

- 2.1. një listë të të gjitha pronave të shitura apo të zgjidhura në mënyra tjera,
- 2.2. një listë të fletëpranimeve dhe pagesave të parasë së gatshme,
- 2.3. një listë përfundimtare të të gjitha kërkesave të lejuara,... dhe
- 2.4. një listë të bilancit të mbetur në llogarinë bankare me shpjegim të qëllimit;

Paragrafi 3, i këtij neni përcakton se: *Autoriteti i Likuidimit dërgon njoftim të aprovimit të Raportit Përfundimtar nga ana e Gjykatës të kreditorët, komiteti i kreditorëve (nëse ekziston) brenda pesë (5) ditëve pas pranimit të aprovimit të Gjykatës për mbylljen e rastit të likuidimit.*

Neni 44 paragrafi 1, i Shtojcës së Ligjit të AKP-së, parasheh që përveç rasteve të rregulluara në paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni, mbyllja e rastit ndodh kur Gjykata aprovon raportin përfundimtar të Autoritetit të Likuidimit sipas nenit 43 të kësaj Shtojce.

Me dt.09 gusht 2005, Bordi i Drejtorëve të AKP-së ka nxjerr vendim për themelimin dhe përbërjen e Autoritetit të Likuidimit për NSH MIT034 Ndërmarrja Shoqërore "Trepça Konfeksioni" në likuidim – Mitrovicë e Jugut, i ndryshuar me dt.01 janar 2024.

Me dt.21 korrik 2005, NSH –ja është vendosur në likuidim dhe Autoriteti i Likuidimit pasi ka iniciuar procesin e likuidimit të kësaj NSH-je, ka publikuar Njoftimin e parë me dt. 31 gusht 2005 për fillimin e Likuidimit në gjuhën shqipe në gazetën Express dhe Blic si dhe në gjuhën serbe në gazetën Danas, në Serbi. Po ashtu Bordi i drejtorëve kishte vendosur që të gjitha njoftimet për kreditorët e AKP-së të bëhen në web faqen zyrtare të AKP-së të cilat edhe janë bërë. Raportit i janë bashkëngjitur dëshmitë e publikimit të këtyre njoftimeve.

AL ka dërguar njoftimet përkatëse për fillimin e Likuidimit të kësaj NSH-je tek institucionet relevante dhe kreditorët potencialë. Me dt.22 gusht 2005 ishin njoftuar gjykatat si: Gjykata Komunale në Mitrovicë, Gjykata e Qarkut në Mitrovicë, Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë, Gjykata Supreme e Kosovës dhe Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme ndërsa, me dt.23 gusht 2005 është njoftuar edhe Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve.

AL i NSH-së ka identifikuar se kjo ndërmarrje ka në pronësi Fabrikën duke përfshirë objektin në sipërfaqe 1526m2 dhe tokë me sipërfaqe prej 6588.00m2; Lokal në sipërfaqe prej 45.57m2; Lokal në sipërfaqe prej 111.00m2 dhe tokë në sipërfaqe 6532.00m2.

Nga dokumentacioni i shkresave të lëndës shihet se NSH-ja nuk ka asete ndaj të cilave është hequr dorë e po ashtu Dhoma e Posaçme ka konfirmuar se nuk ka ndonjë ankesë ndaj kësaj NSH-je.

AL në Pasqyrën Përmbledhëse Financiare të llogarisë bankare në Likuidim ka deklaruar se gjithsej të hyra nga likuidimi i NSH-së kanë qenë 355,403.00€, nga to 8,292€ interes i fituar në llogaritë e likuidimit në mirëbesim. Gjithësej shpenzimet – shpërndarjet sipas llojit të shpenzimeve janë 355,174.25 €, nga to 180,488.19 € Fondet tepërisht transferuar Qeverisë së Kosovës sipas nenit 19.3.3 të Ligjit për AKP-në, Ngarkesat bankare 47.40€, Transferi i 20% të punëtorëve (BSPK) nga të ardhurat e shitjes së asetëve gjatë likuidimit 11,221.34€, Tarifa administrative e Agjencisë (5% e shitjeve të likuidimit dhe interesit në llogaritë bankare 3,089.60 €, Ofruesit profesional të shërbimeve 4,000.00€, Ofruesit e shërbimeve 900.00 €, Mallrat, shërbimet, reklamimet dhe shpalljet 4,176.61€, si dhe pagesat e kreditorëve të NSH-së 14,225.42 €. Fondet e mbetura për Qeverinë e Kosovës përfshijnë shumën 137,025.69 €.

Ndërsa, nga bilanci i mbetur në llogaritë bankare vërtetohet se parat në mirëbesim të likuidimit apo që gjinden në llogaritë rrjedhëse në bankë arrijnë shumën totale prej 180,488.19€ të cilat do të përdoren për të mbuluar shpenzimet eventuale të likuidimit të NSH-së ndërsa, fondet e mbetura do të transferohen në buxhetin e Republikës së Kosovës.

AL mbetet përgjegjës për veprimet apo lëshimet joligjore gjatë mandatit të tij, sipas nenit 46 paragrafi 2 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO
REPUBLIC OF KOSOVO

SAKTESINË E KOPJES E VËRTETON REGJISTRUESI
TAČNOST KOPIJE POTVRDUJE REGISTRATOR
ACCURACY OF COPY CERTIFIED BY REGISTRAR

